



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakovica-Gjakova
Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2022

Datë: 29.04.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 dhe 73 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 4, 5 dhe 8.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2022, pas diskutimit lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Themelimi i Komitetit Konsultativ për Arsim, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Paneli përzgjedhës për zhvillimin procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Arsim në Komunën e Gjakovës me këtë përbërje :
 1. znj. Teuta Pallaska Milla, anëtare e Kuvendit
 2. znj. Besarta Lekaj, anëtare e Kuvendit
 3. z. Besim Nda, anëtar i Kuvendit
 4. znj. Eranda Kumnova Baçi, Përfaqësues nga Ekzekutivi
 5. z. Arbër Xharra, përfaqësues i shoqërisë Civile
2. Paneli përzgjedhës i caktuar në pikën e parë të këtij vendimi ka për detyrë që pas përfundimit të procedurave të parapara në Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, ti propozoj Kuvendit të Komunës Listën me emrat e Komitetit Konsultativ për Arsim .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Anëtarëve të panelit përzgjedhës .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Arbëneshë Kuqi
Kryesues e Kuvendit të Komunës